

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kreu i FSDKSH Ilir Topi mashtron me formularin e dekriminalizimit dhe pasurinë, afëra me depot farmaceutike dhe farmaceutë, mafia e ilaçeve vijon skemat e mashtrimit
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/14/kreu-i-fsdksh-ilir-topi-mashtron-me-formularin-e-dekriminalizimit-dhe-pasurine-afëra-me-depot-farmacutike-dhe-farmacite-mafia-e-ilaceve-vijon-skemat-e-mashtrimit-2/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 08:09:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 08:00:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	078ef68324e13de29e5c0c1ae10a3d6bba5e7de2e26236bf2cd54b7187a27e08
TEKSTI	66a9ec948a9c98ebc58fe58ae84c80a8efd3c32f3655feb79c42263e0f2fb7c0
PAMJA	664dc8bed990acd9b5bec6bc33ce82c9acb156220443694a8e95a514c67b2fa6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	420a31f2080d59a260a6f6ffd0ffc21f0b3d213e2f83d65f59516d7d0aeac7f4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ac1c8d986ca8a5982bfff13c00b3f40fb9a36fbd6d516390a812a54ba861f1b0b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahëso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/420a31f2080d59a260a6f6ffd0ffc21f0b3d213e2f83d65f59516d7d0aeac7f4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kreu i FSDKSH Ilir Topi mashtron me formularin e dekriminalizimit dhe pasurinë, afera me depot farmaceutike dhe farmacitë, mafia e ilaçeve vijon skemat e mashtrimit

Kryesore

Publikuar: 14/09/2026



Drejtori i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, i njohur si 'Fondi i oligarkëve', Ilir Topi, deklaron një shtëpi 3-katëshe me sipërfaqe 223.4 m2 dhe sipërfaqe ndërtimi 128 m2/kat, me vlerë rreth 35 mijë euro. Si burim të ardhurash, Topi deklaron të ardhura nga emigracioni, aktiviteti bujqësor dhe kursimet nga pagat.

1.	Shtëpi banimi trekateshe me sip ndertimi 128 m2/kat ne sip.trualli 223.4m2,ndertuar ne vitin 2003 dhe legalizuar ne vitin 2015,me te ardhura te sigurura nga emigracioni, te ardhura nga aktiviteti bujqesor si dhe nga kursimet nga te ardhurat nga punesimi	3.500.000(tre milion e peseqind mije)	100
2.	Autoveture tip Benz,Viti i prodhimit 2008,blere ne vitin 2016,nga te ardhura te siguruar nga shitja e nje autoveture tip Golf si dhe nga kursimet nga punesimi	1.000.000(nje milion)	100
3.	Llogari rjedhese ne Banken [REDACTED]	0(zero) leke	
4.	Toke bujqesore te perfituar per fryme, ne baze te ligjit nr.7501date 19.07.1991 ne fshatin Miras,Devoll,siperfaqe 3000m2,e perفشire ne Aktin e Marjes se Tokes ne Pronesi ne emer te babait Osman Topi ne siperfaqe totale 10220 m2	3000(tre mije) meter katror	33%

* Neni 4, gërma a, b, c, ç, d i Ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar:

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë, dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
- d) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- e) vlerën e likuiditeteve, gjendje në Cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;

* Neni 4/1. Subjekti deklarues që plotëson deklarinimin për herë të parë, nuk mund të mbajë dhe të deklarojë gjendje në Cash jashtë sistemit bankar mbi shumën 1.5 (një presje pesë) milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve Cash mbi vlerën 1.5 (një presje pesë) milion lekë është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së interesave private në ILDKPKI.

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni në kopje të tij.

"Para Fillimit të Detyrës"

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i subjektit deklarues

ILIR TOPI

3

Me te lexuarat

Ramen në Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t'ia dhënë Besnik Leskaj
Besnik Leskaj pasi Leskaj i mori në punë të birin. Postet në

Ministria e Punëve të Brendshme, i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë
Bredmet e Ilka

Kukalajt në OSHISH, Spahiu i përgjigjet kritikave: Menaxhere shpirtërore, shpirtërore, shpirtërore
shpirtërore


Ushqimeve në Shqipëri, shtrenjtohen 5 herë më shpejt se në BE

Ilir Topi, me eksperiencë si doganier në Korçë dhe tatimor në

Tiranë, ka plotësuar formularin e dekriminalizimit në mars të vitit 2021 në kuadër të mandatit të deputetit të Partisë Socialiste. Në formularin e dekriminalizimit, Topi nuk deklaroi se ka jetuar jashtë shtetit për arsye emigracioni. Ilir Topi deklaroi se ka qëndruar gjatë periudhës 1995-1997 në Kretë të Greqisë për studime, por jo si emigrant, duke justifikuar shtëpinë 3-katëshe.

Qyteti dhe Shteti ku keni jetuar	Arsyeja	Periudha	Adresa e vendqendrimit
CHANIA CRETE GREQI	STUDIME	1995-1997	MAICH CHANIA CRETE GREQI

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

ILIR TOPI 
(emër, mbiemër, nënshkrim)

Kreu i 'Fondit të oligarkëve' pretendon, në CV-në e tij si deputet, shkruan se gjatë periudhës 1995-1996 ka qenë në Greqi për studime pasuniversitare në Institutin Agronomik Mesdhetar, Studime të Avancuara; Maich, Kretë, ndërsa në formular thotë se studimet i ka kryer gjatë periudhës 1995-1997, pra një vit më shumë. Të gjitha këto të dhëna kontradiktore, të deklaruar nga vetë Topi në deklaraten e pasurisë, formularin e dekriminalizimit dhe CV-në si deputet, ngrenë dyshime të forta për deklarim të rremë të pasurisë si dhe për veprën penale 'falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve'.

Afera me depot dhe farmacitë

Në shtator të vitit të kaluar, ish drejtori FSDKSH Spartak Zekja është arrestuar me urdhër të Prokurorisë së Tiranës, e cila kishte gjetur një skemë të mirëfilltë zhvatjeje dhe mashtrimi në bashkëpunim me simbolin e mafies së ilaçeve Nadir Çaushollin dhe persona të tjerë, ndërkohë që hetimet prekën edhe disa zyrtarë të tjerë të Fondit. Disa evidenca dhe sinjalizime tregojnë se "trashëgiminë" e lënë nga Zekja po e vijon Ilir Topi, duke favorizuar sërish oligarkët, sidomos ata të cilët e kanë vendosur në atë post.







Ashtu si Zekja, edhe Ilir Topi lejon një rrjet farmacish të vijnë skemën e mashtrimit me ilaçet e rimbuesueshme, ndërsa depot farmaceutike vijnë pa u shqetësuar nga kontrollet kontrabandën e ilaçeve dhe tregtimin në shumë raste të barnave të skaduara, falsifikuara si dhe shitje fiktive. Gjithashtu, Topi ka firmosur rikthimin e kontratës për “CFO Pharma”, një kompani në pronësi të Nadir Çauhallit, e dyshuar nga Prokuroria e Tiranës për krijimin e një skeme mashtruese me rimbursimin e medikamenteve në vlerën 700 mijë euro.

Ilir Topi ka injoruar tërësisht një raport të ri për “CFO Pharma”, ku dyshohet se mashtrimi arrin në të paktën 1.6 milionë euro të tjera. Në 16 Tetor 2025, ish-drejtori i Fondit, Arti Papajani, firmosi ndërprerjen e kontratës me kompaninë e Çauhallit, në vijim të një hetimi administrativ, ku u zbuluan shkelje të rënda financiare me rimbursimin e dy medikamenteve, “Trimbow” dhe “Foster”. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Komisioni i Apelit Administrativ i Ministrisë së Shëndetësisë.

FSDKSH, institucioni më i korruptuar në Shqipëri

Dosjet e SPAK dhe Prokurorisë së Tiranës, operacione policore, disa raporte të KLSH dhe investigime mediatike e vizatojnë Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) si institucionin më të korruptuar në Shqipëri, pavarësisht arrestimeve të herëpashershme, denoncimeve mediatike, auditimeve të shpeshta të KLSH, rekomandimeve dhe ndryshimit të drejtorëve. I quajtur ndryshe si Fondi i Oligarkëve, për shkak se çdo drejtues ka ndjekur interesat korruptive të një rrethi biznesmenësh në shëndetësi, FSDKSH ka ndryshuar të paktën 14 drejtorë në 13 vitet e fundit.





Ata janë **Astrit Beci, Milva Ekonomi, Vjollca Braho, Erion Manohasa, Alketa Hila Eduard Ahmeti, Anila Denaj, Adela Xhemali, Rudina Degjoni, Elisa Bërziu, Albana Çela, Spartak Zekja, Arti Papajani dhe drejtori aktual Ilir Topi**, i cili disa ditë më parë ka firmosur rikthimin e një kontrate me natyrë korruptive për “CFO Pharma”, një kompani në pronësi të Nadir Çaushollit, e dyshuar nga Prokuroria e Tiranës për krijimin e një skeme mashtruese me rimbursimin e medikamenteve në vlerën 700 mijë euro.

Krahas skemave sistematike në bashkëpunim me farmacitë dhe depot farmaceutike me rimbursimet fiktive, ilaçe të skaduara, kontrabandën, monopolet, skemave të mashtrimit etj., drejtuesit e FSDKSH kanë mundësuar edhe zbardhimin e deformuar të kontratave të katër koncensioneve në shëndetësi, hemodializa, check-up-it, laboratorëve dhe sterilizimit, të certifikuara si korruptive nga KLSH dhe pjesërisht nga gjykata, ndërsa që të gjitha të dyshuara si korruptive nga SPAK. FSDKSH, sipas dosjeve të SPAK dhe raporteve të KLSH kanë paguar përfituesit e këtyre koncensioneve për punë të pakryera.

Para emërimit në krye të FSDKSH, kandidati duhet të pranojë disa kushte, pasojat penale të mundshme dhe sigurisht përfitimet. Kushtet përfshijnë intereset korruptive të rrethit të biznesmenëve në dëm të buxhetit të shtetit dhe shëndetit të shqiptarëve. Nuk ka asnjë mundësi që i piketuari të emërohet në krye të Fondit pa pranuar paraprakisht se do të finalizojë aferat korruptive të diktuar nga linjat e interesit që po i mundëson emërimin.

Zakonisht, oligarku që dikton drejtorin e Fondit, i jep atij njëfarë garancie për një proces sa më të lehtë penal dhe mbulim të pasurive, produkt i aferave korruptive. Kjo është edhe arsya se pse pothuajse të gjithë ish drejtorët e FSDKSH janë me dosje penale, por asnjëri prej tyre nuk ka bërë burg. Shumica e drejtorëve të FSDKSH kanë një pasuri me vlerë miliona euro, ndërsa besohet se pjesën më të madhe të pasurisë e kanë kamufluar në emër të njerëzve të besuar.

FSDKSH si organizatë kriminale, mbulon barnat e skaduara të depove farmaceutike

Një tjetër raport prej 413 faqesh i Kontrollit të Lartë të Shteti

konfirmon edhe një herë se Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor vijon të mbetet një institucion që gjeneron abuzime, skema korruptive, mashtrim dhe pazare me shëndetin e shqiptarëve, pavarësisht arrestimeve të herëpashershme, denoncimeve mediatike, auditimeve të shpeshta të KLSH dhe ndryshimit të drejtorëve, 11 drejtorë në 13 vite.

Skema vijon të mbetet e njëjtë. Kupola e FSDKSH-ja favorizon dhe mbulon abuzimet, kontrabandën dhe mashtrimet e depove farmaceutike dhe farmacive, ndërsa ndajnë bashkë paratë produkt i aktivitetit kriminal në dëm të shëndetit të shqiptarëve.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.